Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë
Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

DEKLARATË E PERPUTHSHMERISE SË LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME ACQUIS TË BE-së

1. **Organi propozues i aktit normativ:** Ministria e Drejtësisë.

2. **Titulli i projekt aktit normativ:** Projektligji për Ratifikimin e Traktatit mbi Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane.

3. **Përputhshmëria e aktit normativ me dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ose Marrëveshjes së Përkohshme.**

3.1 dispozitat e MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme në lidhje me përmbajtjen normative të aktit normativ.

NENI 7

Zhvillimi i bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore, si dhe respektimi i të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve, janë të rëndësishme për PSA-në. Arritja dhe zbatimi i kësaj Marrëveshje bëhet në kuadër të PSA-së dhe bazohet në vetë meritat e Kosovës.

NENI 8

Kosova zotohet të vazhdojë nxitjen e bashkëpunimit dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në rajon, duke përfshirë një nivel të përshtatshëm të koncesioneve të ndërsjella lidhur me lëvizjen e personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët në një gamë të gjerë të fushave, përfshirë sundimin e ligjit. Ky zotim përbën një faktor kyç për zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet Palëve, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal.

NENI 17

Bashkëpunimi me vendet tjera që kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit Pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, nëse e lejojnë rrethanat objektive, Kosova do të nisë negociatat me vendet që tashmë kanë nënshkruar një Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit me BE-në me qëllim të nënshkrimit të konventave dypalëshe për bashkëpunim rajonal, synimi i të cilave do të jete shtimi i fushave të bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Elementet kryesorë të këtyre konventave do të jenë:
(a) dialogu politik;
(b) vendosja e zonave të tregtisë së lirë, në përputhje me dispozitat përkatëse të OBT-së;
(c) koncesione të ndërsjella lidhur me lëvizjen e punonjësve, themelimin, ofrimin e shërbimeve, pagesat rrjedhëse dhe lëvizjen e kapitalit, si dhe politika të tjera që kanë të bëjnë me lëvizjen e

personave në një nivel të barabartë me atë të Marrëveshjeve të Stabilizim- Asociimit, që ai saktë përkatës ka lidhur me BE-në;
(d) dispozitat për bashkëpunimin në fusha tjera të cilat mbulohen apo nuk mbulohen nga kjo marrëveshje. Kryesisht në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Këto konventa do të përmbajnë dispozita për krijimin e mekanizmave të nevojshëm institucional, sipas nevojës. Konventat do të nënshkruhen brenda dy viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje.

NENI 83
Fuqizimi i institucioneve dhe sundimi i ligjit

Sa i përket bashkëpunimit të tyre në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, Palët do të kushtojnë rëndësi të veçantë konsolidimit të sundimit të ligjit, dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi dhe administrimit të zbatimit të ligjit dhe administrimit të drejtësisë në veçanti. Bashkëpunimi synon veçanërisht fuqizimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe Llogaridhënies së gjyqësorit në Kosovë dhe përmirësimit të efikasitetit të tij, zhvillimin e strukturave të përshtatshme për policinë, prokurorët dhe gjyqtarët dhe organet tjera gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit për të i përgatitur ata në mënyrë adekuate për bashkëpunim në çështjet penale, tregtare dhe civile dhe për t'ju mundësuar atyre që në mënyrë efektive të parandalojnë, hetojnë, ndjekin penalisht dhe gjykojnë krimin e organizuar, korrupsionin dhe terrorizmin.

3.2 Afati kohor i përcaktuar për përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit në përputhje me dispozitat e MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme

NENI 74

1. Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues të Kosovës me atë të BE-së dhe të zbatimit të tij efektiv. Kosova do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkoj gradualisht drejt përputhjes me acquis së BE-së.
Kosova do të sigurohet se ligjet ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm do të implementohet dhe zbatohet siç duhet.

2, Ky përafrim do të fillon në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, dhe do të shtrihet gradualisht në tërë elementët e acquis-it të BE-së të cekura në këtë Marrëveshje deri në fund të periudhës transitore të përcaktuar në nenin 9.

NENI 9

Asociimi në mënyrë progresive dhe të plotë do të realizohet gjatë një periudhe prej dhjetë vitesh.

--

Nuk ekziston ndonjë afat i caktuar për bashkëpunim rajonal në Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim, mirëpo përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit vendor me acquis communautaire është shumë i rëndësishëm dhe ndikon në plotësimin e kushteve për anëtarësim në Unionin Evropian si dhe në forcimin e bashkëpunimit me vende të rajonit.

3.3 Vlerësimi i nivelit të përmbushjes së detyrimit /obligimit që rrjedh nga dispozitat e lartpërmendura të MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme.

I plotë.

3.4 Arsyet për përmbushjen të pjesshme, ose mosplotësimi/dështimi për përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga dispozitat e lartpërmendura të MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme

Nuk zbatohet

3.5 Ndërlidhja me Programin Kombëtar për Integrim (PKI/ NPAA (në rastin e nevojës ndërlidhja me PVPE).

Nuk zbatohet.

4. Përputhshmëria e legjislacionit me Acquis e BE-së

4.2 Lista e burimeve sekondare të së drejtës të BE-së dhe përputhshmëria me to.

Nuk zbatohet.

4.3 Lista e burimeve tjera të së drejtës të BE dhe përputhshmëria me to.

Nuk zbatohet.

4.4 Arsyet për përputhje të pjesshme, apo mospërputhje.

Nuk zbatohet.

4.5 Periudha kohore brenda së cilës është e paraparë realizimi i plotë i përputhshmërisë të legjislacionit me Acquis e BE.

Nuk zbatohet.

5.Të specifikohet kur nuk ka legjislacion të BE-së me të cilën përputhshmëria është e kërkuar.

Nuk ka legjislacion të BE-së me të cilën përputhshmëria është e kërkuar.

6. A janë burimet e lartpërmendura të së drejtës së BE-së të përkthyera në gjuhët zyrtare;

Nuk zbatohet.

7. Pjesëmarrja e konsulentëve në hartimin e akteve normative dhe mendimin e tyre për përputhshmërinë (të bashkangjitur shkresat e konsulentëve për hartimin e akteve normative).

Nuk zbatohet

Ardian Bajraktari

Drejtor i Departamentit Ligjor

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

__/__/2022